



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
KABINETI

Bulevardi "Bajram Curri" Tirana, Albania - Tel/Faks. +355 4 36462937 - www.moh.gov.al

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____ 2011

Lënda : Realizimi i treguesve të monitorimit financiar për Ministrinë e Shëndetësisë per 9 mujorin e vitit 2011.

Drejtuar : **MINISTRISË SË FINANCAVE**

DREJTORISË SË PËRGJTHSHME TË BUXHETIT

Në zbatim të Ligjit Nr. 9936 datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor ne Republikën e Shqipërisë", Ligjit Nr.10355 date 2.12.2010 "Per buxhetin e vitit 2011", ne zbatim te Udhezimit Nr. 4 date 27.1.2011 "Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011" bashkëlidhur ju dërgojmë informacionin për realizimin e buxhetit të nentemujorit te vitit 2011.

Duke ju falenderuar,

SEKRETARE E PERGJITHSHME

MIRELA CANO

Raporti i monitorimit per Ministrine e Shendetesise per nentemujorin e vitit 2011

Ministria e Shendetesise , per vitin 2011, administron dhe menaxhon fondet publike sipas kater programeve te miratuara, si vijon:

1. Planifikim menaxhim administrim
2. Sherbime te kujdesit shendetesor paresor
3. Sherbime te kujdesit shendetesor dytesor
4. Sherbime te shendetit publik

Realizimi i shpenzimeve te buxhetit per nentemujorin e vitit 2011, paraqitet si me poshte vijon:

Titulli	Emri i Programit	Buxheti 2011 ne mije leke	Fakti 2011 ne mije leke	% e realizimit 2011	Struktur a ne % fakti 9 mujori 2011
O110	Planifikim Menaxhim Administrim	288.922	202.507	70%	0.9%
O7220	Sherbime te Kujdesit Shendetesor Paresor	8.619.405	7.070.401	82%	32%
O7330	Sherbime te Kujdesit Shendetesor Dytesor	16.954.310	13.075.987	77%	59.2%
O7450	Sherbime te Shendetit Publik	2.629.053	1.720.470	66%	7.8%
Totali i shpenzimeve te ministrise		28.491.960	22.069.365	77%	100

Struktura e shpenzimeve sipas programeve paraqitet si me poshte vijon:

Ne
perqindje

Titulli	Emri i Programit	PBA Plan 2011	Budget 2011	Fakti 2011
O110	Planifikim Menaxhim Administrim	1.0	1	0.9
O7220	Sherbime te Kujdesit Shendetesor Paresor	30.1	30.3	32

O7330	Sherbime te Kujdesit Shendetesor Dytesor	59.5	59.5	59.2
O7450	Sherbime te Shendetit Publik	9.4	9.2	7.8
Totali		100.0	100.0	100.0

Rreth 1% te totalit te shpenzimeve faktike eshte perdorur per programin planifikim menaxhim administrim. Per programin sherbime te kujdesit shendetesor paresor eshte perdorur 32%. Per programin sherbime te kujdesit shendetesor dytesor eshte perdorur rreth 59.2%, ndersa per programin sherbime te shendetit publik eshte perdorur rreth 7,8% te totalit te fondeve te perdorura.

Me poshte po paraqesim nje analize te detajuar te treguesve te monitorimit te buxhetit sipas programeve buxhetore.

1. Programi Planifikim Menaxhim Administrim

Objektivat kryesore te ketij programi jane:

- Zbatimi i planit afat shkurter te perafimit te legjislacionit
- Plotesimi i kushteve te punes ne nivel qendror (MSH) dhe institucioneve te tjera te ketij programi.
- 1% e stafit te profesionisteve te shendetit te trajnuar nga qendra e formimit te vazhdueshem profesional
- Hartimi i strategjise per shtrirjen e praktikese vleresimit te performances se spitaleve me ane te treguesve perkates

Realizimi i shpenzimeve te gjashtemujorit te pare per kete program perben 0.9% te totalit te shpenzimeve te kesaj ministrie . Krahasuar me planin vjetor sipas zerave kryesore rezulton si me poshte:

Shpenzime korente 69%

Shpenzime kapitale 76%

Ne kete program jane parshikuar te realizohen produktet e meposhteme, ecuria e te cilave krahasuar me planin paraqitet si vijon:

Ne mije leke

	Buxheti	Fakti	Statusi i realizimit
Emri i Produktit	2011	2011	9M
Menaxhimi i pol. sektoriale	248.922	172.044	Plotesisht

Bl. Paj mobil zyre kompjuterike	5.390	1.078	Pjeserisht
Proj te mbesht me det dog e kl	3.850	1.345	Pjeserisht
Ndertim e rikonst ambjentesh aparati	30,760	28.040	Plotesisht

Ne zerin “Menaxhimi i politikës sektoriale” janë përfshirë shpenzimet korentë për institucionet e këtij programi. Deri në fund të vitit në këto ze do të shpenzohen të gjitha fondet e mbetura. Këtu duhet theksuar se pakesimi i fondeve sipas buxhetit të rishikuar për vitin 2011 ka sjellë vështirësi në likuidimin e detyrimeve deri në fund të vitit.

Në zerin “Bl.pajisje mobilimi, zyre, kompjuterike” të paraqitur në tabelën e mësipërme bëhen pjesë dhe objektet me vlerën 3.469 mijë lekë të destinuar për blerje kompjuterash për aparatet e MSH, por që nuk është bërë e mundur realizimi i këtij investimi. Arsyeja janë, si vijojnë: a) çelja e fondit në fillim të vitit është bërë me emërtimin “fond i ngrirë”; b) në muajin maj të këtij viti u arrit shkëmbimi i tij dhe procedura e prokurimit duhej të kryhej nga ana e Ministrisë së Brendshme, por që nuk u arrit të realizohej për arsye të V.K.M Nr. 472, datë 02.07.2011, “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore, për vitin 2011”, pikë 2 “të gjitha fondet buxhetore që i nënshtrohen procedurave të prokurimit publik, që deri më 01/08/2011 rezultojnë të paprocuruara (që nuk është lidhur kontrata), bllokohen.

2. Programi Shërbime të Kujdesit Shëndetësor Paresor

Objektivat kryesore të këtij programi janë:

- Përmirësim i ofrimit të shërbimit paresor nëpërmjet zgjerimit të skemës së medikamenteve nga 409 që ishin në 2010, në 420 barna në vitin 2011
- Zvogelim i vdekshmërisë foshnjore në vitin 2011 me 0.5 për 1000 krahasuar me vitin 2010
- Zvogelim i vdekshmërisë amtare me 1/100000 në vitin 2011 krahasuar me 17 për 100000 që është në vitin 2008
- Rritja e vizitave/kontakteve të pacientit në kujdesin paresor në 8.6 vizita/dite/mjek në vitin 2011 nga 8.4 në vitin 2010
- Plotësim në masën 58% të standarteve të infrastrukurës krahasuar me 50% që realizohen në 2011
- 9% e popullsisë të mbuluar me shërbim parandalues çdo vit

Realizimi i shpenzimeve te tremujorit te pare per kete program perben 32% te totalit te shpenzimeve ke kesaj ministrie . Krahasuar me planin vjetor sipas zerave kryesore rezulton si me poshte:

Shpenzime korente 85%

Shpenzime kapitale 56%

Ne kete program jane parashikuar te realizohen produktet e meposhteme, ecuria e te cilave krahasuar me planin paraqitet si vijon:

	Buxheti	Fakti	Statusi i realizimit
Emri I Produktit	2011	2011	9M
Sigurimi i mbulimit me barna per popullsine aktive dhe jo aktive	6.200.000	4.756.000	Plotesisht
Mbulimi i KSHP	1.285.000	1.237.000	Plotesisht
Rikonstruksione te qsh dhe ambulancave (p vendor)	37.000	0	Aspak
Ndert.te reja te qsh dhe ambulancave (p vendor)	63.000	0	Aspak
Bl. Pajisje mobilimi per qsh	8.000	0	Aspak
Bl.pajisje mjeksore grupi I	58.926	23.615	Pjeserisht
Bl. Pajisje laboratorike klinike per qsh dhe polikl e Tiranes	16.200	12.696	Pjeserisht
Funksionimi i Kl Qeveritare	21.321	14.309	Plotesisht
Funksionimi i KSU	43.900	27.985	Plotesisht
Staf mjeksor i trajnuar	2.000	0	Aspak
Projekti modernizimit te sistemit shendetesor BB	344.682	260.451	Pjeserisht
Fuqizimi i pergjigjes kombetare ndaj HIV AIDS	90.431	57.955	Pjeserisht
Pershkallezimi i pergjigjes kombetare ndaj TBC	16.545	5.645	Pjeserisht
Trajtimi i pac ne spit e duresit	670.000	519.000	Plotesisht
Ndertime e rikonstruksione per godinat e KSHP	74.364	42.967	Pjeserisht
Pajisje mobilimi, teknologjike, elektrike per godinat e KSHP	12.526	2.978	Pjeserisht
Ndertimi i qsh dhe ambulancave nga Gjysem Hena e Kuqe	18,000	9.810	Pjeserisht

Per sa i perket “Rikonstruksione te qendrave shendetesore dhe ambulancave (pushteti vendor) dhe Ndert.te reja te qendrave shendetesore dhe ambulancave (pushteti vendor)” paraqiten me mosrealizim per arsye se vendimi i ndarjes se fondit sipas njesive te qeverisjes vendore u miratua me 11.3.2011 dhe celja e ketyre fondeve nga ana e Ministrise se Financave eshte bere ne gusht te v.2011. Te gjitha njesite e qeverisjeve vendore te cilave iu eshte akorduar fondi per ndertime te reja apo rikonstruksione te QSH-ve dhe Ambulancave, kane perfunduar procedurat e prokurimit dhe jane ne procesin e zbatimit te punimeve te ndertimit.

Per Projektin modernizimit te sistemit shendetesor (financim i BB), kane perfunduar:

- 1) Instalimi dhe venia ne pune e 4 mamografeve per spitalet rajonale (Elbasan, Fier, dhe Korce) si dhe per QSUT.
- 2) Ka perfunduar instalimi dhe venia ne pune e nje seti pajisjesh endoskopike, respiratore dhe anesteziqe per te gjitha spitalet rajonale dhe spitalet universitare te Tiranës

Jane ne procedure prokurimi me nje vlere agregate prej 350 milione lekesh

- (i) Pajisje mjekesore per Kirurgjine Pediatrike,
- (ii) (ii) per Departamentin e Kardiologjise ne QSUT me nje vlere agregate 350000(000/lek)

Brenda muajit nentor lidhet kontrata per nje tender per IT e ISKSH me nje vlere prej 200 milione lekesh.

Disbursimi i plote i Projektit realizohet brenda 31 marsit 2012.

Per projektet “Fuqizimi I pergjigjes kombetare ndaj HIV AIDS” dhe Pershkallezimi I pergjigjes kombetare ndaj TBC” jemi ne fazen permbyllese.

Per “Ndertime e rikonstruksione per godinat e Kujdesit shendetesor paresor” pavaresisht vleres se vogel te financimit te realizuar, vlere e prokuruar deri ne periudhen per te cilen flasim kap vleren e rreth 75milion lekeve.Jane lidhur kontratat per ato objekte qe jane prokuruar dhe financimi per keto objekte eshte realizuar ne masen 60%.Deri ne fund te vitit do te kemi dhe financimin e plote per keto objekte.Nga vlere 75milion leke vetem 6milion leke nuk kane arritur te prokurohen. Po i njejti arsyetim vlen dhe per “Pajisje mobilimi, teknologjike, elektrike per godinat e kujdesit shendetesor paresor”, pershume prej te cilave jane perfunduar procedurat e prokurimit, per shume prej tyre eshte bere dhe financimi.Persa i perket “Blerje pajisje mjekesore grupi I”, me vlere totale 58.926milion leke, jane perfunduar procedurat e prokurimit per pajisjet mjekesore qe kapin vleren ne total prej rreth 40milion lekesh. Ka filluar levrimi I ketyre pajisjeve dhe jane financuar rreth 40% te tyre(per 9mujorin).Vetem 12milion leke pajisje mjekesore te grupit I nuk kane arritur te prokurohen, nga te cilat 5milion celur per grafine e QSH ne Vore dhe 5.5milion per dy ECO portable te sh.paresor ne Tirane. Pjesa tjeter eshte plotesisht e realizueshme deri

ne fund te v.2011. Investimi tjetër “Blerje pajisje mobilimi per QSH dhe Ambulanca” me vlere 8 milion leke eshte realizuar si procedure prokurimi dhe aktualisht po kryhet shperndarja e pajisjeve neper qendrat shendetesore dhe ambulancat perfituese.

3. Programi Sherbime te kujdesit shendetesor dytesor

Objektivat kryesore te ketij programi jane:

- Mbulim 82% i nevojës për shërbim spitalor në vitin 2011 krahasuar me 80% që janë plotësuar në 2010
- Plotësim 77% i nevojave të spitaleve rajonale me pajisjet e domosdoshme mjekësore në shërbimet bazë (patologji, kirurgji, pediatri), në vitin 2011, referuar 70% që plotësohen 2010
- Plotësim në masën 40% i nevojave për pajisje që trajtojnë mbetejet spitalore në spitalet rajonale nga 20% që është aktualisht.
- Plotësim në masën 100% i nevojave bazë të urgjencave të spitaleve rajonale dhe urgjencës pediatrike të Tiranës krahasuar me 50% të plotësuara në vitin 2010
- Plotësim 100% i nevojave të imazherisë diagnostikuese në 6 spitale rajonale dhe në QSUT, krahasuar me 40% që ishte në vitin 2010
- Plotësimi i nevojave me pajisje mjekësore në Shërbimin e Neurokirurgjisë në Spitalin Nënë Tereza në masën 100% nga 45% që ka qenë në vitin 2010.
- Plotësimi në masën 35% krahasuar me 30% që është aktualisht, të sistemeve të informacionit klinik dhe financiar, si dhe krijimit të një sistemi monitorimi për matjen e performancës së spitaleve.

Realizimi i shpenzimeve të tremujorit të parë për këtë program përben 59.2% të totalit të shpenzimeve të kësaj ministrie. Krahasuar me planin vjetor sipas zerave kryesore rezultojnë si më poshtë:

Shpenzime korente 74%

Shpenzime kapitale 93%

Në këtë program janë parashikuar të realizohen produktet e mëposhtme, ecuria e të cilave krahasuar me planin paraqitet si vijon:

Emri I Produktit	Buxheti 2011	Fakti 2011	Statusi I realizimit
Trajtimi i pacientëve të shtruar në spitale	13.045.000	9.652.000	Plotësisht

Mbulimi financiar i sherbimeve ne spitalet psikiatrike	502.966	356.178	Plotesisht
Funksionimi i instituc. Kombetare	540.214	404.035	Plotesisht
Projekte te mbeshtetura me kosto lokale	14.000	13.132	Plotesisht
Blerje pajisje te medha dhe komplekse per sp Shkoder	145.600	0	Aspak
Blerje pajisje mjeksore komplekse per spitalet rajonale kredia austriake	188.066	191.784	Pjeserisht
Blerje pajisje specifike per neurokirurgjine	79.070	523.104	Pjeserisht
Blerje pajisje mjeksore per Spitalin Kavaje	24.200	13.645	Plotesisht
Blerje pajisje mjeksore per sherbimin e urgjences	800.000	797.484	Plotesisht
Blerje pajisje te tjera mjeksore	69.350	17.800	Pjeserisht
Blerje pajisje mjeksore per S.U.S.M	200.000	200.000	Plotesisht
Blerje pajisje mobilimi, kompjuterike, elektrike , teknologjike, mobilimi	70.827	28.756	Pjeserisht
Rehabilitimi i Sp.Shkoder - kredi F3	476.830	372.224	Pjeserisht
Permiresimi i qendres se djegieve plastike ne QSUT	60.621	32.897	Pjeserisht
Ndertime e rikonstruksione te ambjenteve te sh.spit	719.686	471.703	Pjeserisht

Per “Blerje pajisje te medha dhe komplekse spitali Shkoder”, eshte realizuar vetem nje lot i procedures se prokurimit dhe kontrata ka vleren 76.300.000 leke. Aktualisht jemi ne fazen e levrimit te pajisjeve dhe per kete arsye nuk eshte kryer asnje financim.

Per “Blerje pajisje mjeksore komplekse per spitalet rajonale kredia austriake” jemi ne fazen e pergatitjes se ambjenteve ku do te instalohen pajisjet. Aktualisht, vetem ambienti i QSUT i percaktuar per instalimin e nje rezonance(nga ky project) eshte bere gati. Eshte bere gati edhe ambjebti I Spitalit Lezhe per instalimin e nje skaneri.

Ndersa ambientet e tjera te percaktuara per instalimin e 5 scanerave te tjere dhe te 2 rezonancave nuk jane bere gati.

Per “Blerje pajisje mjeksore per sherbimin e urgjences” (Granti japonez), pajisjet kane ardhur dhe jane instaluar dhe jane ne gjendje pune

Per projektin “Permiresimi i qendres se djegieve plastike ne QSUT” (financim i KE),

Jemi ne fazen e zbatimit te punimeve. Projekti perfundon ne qershor 2012.

Per projektin “Blerje pajisje mjekesore per neurokirurgjine” (financim nepermjet kredise austriake).

Ka nje ecuri me te shpejte te disbursimit krahasuar me planifikimin ne fillim te vendit.

Ky projekt perfundon ne fund te vitit 2012. Perfundimi i ketij projekti eshte i kondicionuar nga ndertimi i godines (bunker) te LINAC, qe finacohet nga buxheti i shtetit per vitin 2012.

Per “Rehabilitimi I spitalit Rajonal Shkoder Faza III.”

Ka avancim te punimeve si ne (punime ndertimi, punime elektrike dhe mekanike) dhe sistemim te ambienteve te jashtme si dhe ne blerjen dhe montimin e pajisjeve teknologjike te ndertimit, te cilat kane vlere te konsiderueshme. Eshte realizuar rreth 60% e objektiveve te projektit.

Per “Ndertime e rikonstruksione te ambienteve te sh.spitalor” me vlere rreth 720milion leke, jane arritur te realizohen pothuajse te gjitha procedurat prokurimit. Jane ne process ende procedurat e rikonstruksioneve te ambienteve per instalimin e scannerave dhe rezonancave nga kredia austriake, te cilat kapin vleren e rreth 40 milion lekeve. Jane anuluar dy procedura te rendesishme per ndertimin e QFR dhe te godines se administrates ne SUSM, me vlere 30milion leke, te celur per v.2011.

Per “Blerje pajisje mobilimi, kompiuterike, elektrike, teknologjike, mobilimi”, fondi limit ne total qe eshte prokuruar eshte rreth 71milion , nga te cilat vlere ne total qe eshte realizuar (si procedure) eshte 68.238.000 milion leke (96%). Ndersa realizimi i financimit eshte ne masen 41% (per 9mujorin).

Persa I perket “Blerje pajisje mjekesore per spitalet” me vlere totale 69.350.000, jane arritur te realizohen procedurat e prokurimit me vlere 63.000.000 leke (91%). Eshte ne process levrimi I pajisjeve ne spitalet perkatese dhe deri tani realizimi I financimit eshte ne masen 26%.

4. Programi sherbime te shendetit publik

Objektivat kryesore te ketij programi jane:

- Permiresimi i cilesise dhe sigurise se programit te imunizimit permes zevendesimit te vaksines se poliomielitit oral me vaksine poliomieliti injektabel ne forme te kombinuar me antigene te tjere

- Reduktimi i numrit te shperthimeve epidemike me burim ndotjen e ujit ne jo me shume se 3 ne vit ne vitin 2012, krahasuar me mesatarisht 4 ne periudhen 2005-2009

Realizimi i shpenzimeve te tremujorit te pare per kete program perben 7.8% te totalit te shpenzimeve ke kesaj ministrie . Krahasuar me planin vjetor sipas zerave kryesore rezulton si me poshte:

Shpenzime korente	66%
Shpenzime kapitale	42%

Ne kete program jane parshikuar te realizohen produktet e meposhteme, ecuria e te cilave krahasuar me planin paraqitet si vijon:

Ne mije leke

	Buxheti	Fakti	Statusi I realizimit
Emri I Produktit	2011	2011	9 mujori
Blerja e montorimi i vaksinave	220.000	166.601	Plotesisht
Monitorimi i agjenteve mjedisore per ujrat , mjedisin, ushqyerjen, shendetin ne pune,duke respektuar standartet e BE-se.	2.301.033	1.508.510	Plotesisht
Ndert. e rikonst te ambjenteve	43.955	24.422	Pjeserisht
Bl. Pajisje te reja per labororet e shendetit publik	49.161	17.203	Pjeserisht
Blerje pajisje kompjuterike , elektrike , teknologjike	14.904	4.274	Pjeserisht

Per “Blerjen e monitorimin e vaksinave” vaksinat kane ardhur dhe jemi ne proces likujdimi te dergeses se fundit.

Per “Blerje pajisje kompjuterike , elektrike” jane realizuar procedurat e prokurimit ne masen 40%. Pjesa tjeter eshte ende ne proces prokurimi.

Per sa i perket “Blerjes se pajisje te reja per labororet e shendetit publik” fondi ne total per -mujorin, i shperndare ne institucione eshte 49.161.000 leke. Pamvaresisht se fakti i 9-mujorit eshte ne masen 35% kundrejt planit, sqarojme se jane prokuruar rreth 76% e tyre ne vleren 37.608.000 leke. Gjithashtu vlen per t’u theksuar dhe diferenca midis fondit limit(qe prokurohet) dhe vleres se fituar(qe jane lidhur kontratat fituese), qe do te ndikojne ne perqindjen dhe te realizimit te financimit ne fund te vitit.

Per “Ndertime e rikonstrukcione te ambienteve” me vlere rreth 44milion lekesh, pothuajse per te gjitha keto objekte jane realizuar procedurat e prokurimit, pamvaresisht se statusi i realizimit per 9-mujorin eshte 60%- “pjeserisht”.

